



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.42

14 prill

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 2.4.2007	Për veprimtarinë e Entit Rregullator të Energjisë Elektrike gjatë vitit 2006	1099
Ligj nr.9699 datë 26.3.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes strategjike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor European”	1100
Ligj nr.9700 datë 26.3.2007	Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare	1107
Dekret nr.5253 datë 10.4.2007	Për lirim ambasadori	1117
Dekret nr.5254 datë 10.4.2007	Për emërim ambasadori	1118
Dekret nr.5255 datë 10.4.2007	Për emërim ambasadori	1118
Dekret nr.5256 datë 10.4.2007	Për emërim ambasadori	1119

REZOLUTË

PËR VEPRIMTARINË E ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE GJATË VITIT 2006

Kuvendi i Shqipërisë:

- duke njohur rolin e rëndësishëm të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE) në zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sektorit elektroenergetik në Shqipëri;
- duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm monitorimin dhe bashkëpunimin e të gjithë pjesëmarrësve të tregut të sektorit të energjisë elektrike nga ERE-ja;
- duke pasur parasysh domosdoshmërinë e hapjes së plotë të tregut të energjisë elektrike;
- duke vlerësuar bashkëpunimin korrekt të ERE-s me partnerë ndërkombëtarë shumë të rëndësishëm në fushën e energjisë ku ajo aderon;

Konstaton se:

- ERE-ja është institucion i pavarur dhe autoriteti kryesor në rolin e rregullatorit të tregut të energjisë elektrike.
- Tregu i sektorit të energjisë elektrike vazhdon të jetë akoma problematik, me gjithë punën e bërë nga ERE-ja.
- Është e domosdoshme që nga ana e Qeverisë dhe KESH-it të merren të gjitha masat e nevojshme që struktura e prodhimit të energjisë elektrike të garantojë sigurinë e nevojshme të furnizimit të vendit.
- Gjatë vitit 2006, pavarësisht nga thatësira e tejzgjatuar në 6-mujorin e dytë, në furnizimin e vendit me energji ka pasur ndikim negativ dhe faktori njerëzor në administrimin jo në nivelin e duhur nga ana e KESH-it. Në këtë drejtim KESH-i duhet të përmirësojë mënyrën e administrimit të kompanisë dhe të krijojë strukturat e specializuara për operimin në tregun e energjisë elektrike.
- Sfida për reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike përbën objektivin parësor për përmirësimin rrënjësor të gjendjes financiare të KESH-it, si dhe të furnizimit të vendit me energji elektrike me kosto të ulët.

Vlerëson:

- Përpjekjet e ERE-s për zbatimin e detyrave që i ngarkon ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.
- Përpjekjet e ERE-s nëpërmjet rishikimit dhe riazhornimit të disa praktikave dhe sisteme rregullash për krijimin e kushteve të barabarta të operatorëve në procesin e licencimit.
- Arritjen e ERE-s në hartimin e metodologjive për llogaritjen dhe përcaktimin e çmimeve të blerjes nga KESH-i të energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit privatë të energjisë dhe koncesionarët.
- Punën e ERE-s në kompletimin e legjislacionit plotësues të sektorit në zhvillim të energjisë elektrike, që kanë ndikuar drejt hapjes dhe funksionimit normal të tregut të energjisë elektrike, si dhe monitorimin e mbikëqyrjen e plotë të tij.

Kërkon:

- Rritjen e cilësisë së punës së ERE-s dhe ushtrimin e autoritetit të tij në ushtrimin e detyrave që i ngarkon ligji, duke konsoliduar më tej ekspertizën tekniko-ekonomike-juridike dhe përforcimin e rolit të tij si institucion i pavarur, transparent dhe i paanshëm dhe të rrisë komunikimin e informimin me Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin në një shkallë më të gjerë.
- Nxitjen dhe krijimin e një klime konkurrence për alternativat më të vlefshme të investimeve në burimet ekzistuese dhe ato të reja të prodhimit të energjisë elektrike.
- Nga ana e ERE-s të merren në konsideratë të gjithë faktorët ndikues për vazhdimin e reformës tarifore të shitjes së energjisë elektrike, duke pasqyruar kostot reale.
- Impenjimim e ERE-s në bashkërendimin e punës së saj me institucionet e tjera shtetërore, që kanë lidhje me sektorin e energjisë elektrike.
- Impenjimim e ERE-s në llogaritjen e 1kWh të munguar dhe impakti negativ që ka në ekonominë shqiptare.
- Krijimin e bazave për operimin në tregun rajonal të energjisë elektrike nëpërmjet rregullave e procedurave për shkëmbimin dhe shitjen e energjisë elektrike dhe legjislacionit tjetër që ka të bëjë me këtë çështje.

2 prill 2007

LIGJ
Nr.9699, datë 26.3.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES STRATEGJIKE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHËRBIMIT POLICOR EUROPIAN”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja strategjike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor European”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5257, datë 10.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE STRATEGJIKE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHËRBIMIT POLICOR EUROPIAN

Preambul

Republika e Shqipërisë dhe Shërbimi Policor (Europol), të referuara më poshtë Palët:
duke vlerësuar se është në interesin e tyre të përbashkët të rrisin bashkëpunimin në luftën kundër formave të rënda të krimit ndërkombëtar;
duke marrë në konsideratë se Këshilli i Bashkimit European i ka dhënë Europol-it autorizimin për të hyrë në bisedime mbi një Marrëveshje bashkëpunimi dhe për të rënë dakord me Republikën e Shqipërisë për dispozitat e mëposhtme,
kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është rritja e bashkëpunimit të Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit European, që veprojnë nëpërmjet Europol-it, për parandalimin, zbulimin, shtypjen dhe hetimin e formave të rënda të krimit ndërkombëtar në fushat e përmendura në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, në veçanti nëpërmjet shkëmbimit të informacionit strategjik dhe teknik, sikurse përcaktohet në nenin 2. Kjo Marrëveshje nuk autorizon transmetimin e të dhënave që lidhen me një individ apo me individë të identifikueshëm.

Neni 2

Informacioni strategjik dhe teknik

1. “Informacioni strategjik” përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

- a) veprime për zbatimin e ligjit, që mund të jenë të dobishme për të shtypur veprat penale dhe në veçanti, mënyra të specializuara të luftës ndaj veprave penale;
 - b) metoda të reja të përdorura në kryerjen e veprave penale;
 - c) prirje dhe zhvillime në metodat e përdorura për kryerjen e veprave penale;
 - d) vërejtje dhe përfundime që dalin nga zbatimi i suksesshëm i ndihmave dhe teknikave të reja për zbatimin e ligjit;
 - e) itineraret dhe ndryshimet në itineraret e përdorura nga kontrabandistët ose nga ata që janë përfshirë në vepra penale të trafikut të paligjshëm që mbulohen nga kjo Marrëveshje;
 - f) strategji të parandalimit dhe metoda për menaxhimin për të zgjedhur prioritetet për zbatimin e ligjit;
 - g) vlerësime të kërcënimeve dhe raporte për situatën kriminale.
2. “Informacioni teknik” përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:
- a) mënyra për forcimin e strukturave administrative dhe të zbatimit të ligjit në fushat që mbulon kjo Marrëveshje;
 - b) metoda të Policisë Shkencore dhe procedura hetimore;
 - c) metoda për trajnimin e zyrtarëve të interesuar;
 - d) metoda analitike të sistemit të informacionit kriminal;
 - e) identifikimin e ekspertizës/njohurive të specializuara për zbatimin e ligjit.

Neni 3

Fushat e kriminalitetit për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje

1. Bashkëpunimi, sikurse përcaktohet në këtë Marrëveshje, do të lidhet në linjë me interesin e Palëve për bashkëpunim në rast të veçantë, me të gjitha fushat e krimit brenda mandatit të Europol-it në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë veprat penale që lidhen me këto fusha.

2. Veprat penale që lidhen me fushat e kriminalitetit do të konsiderohen veprat penale të kryera me qëllimin sigurimin e mjeteve për kryerjen e akteve kriminale të përmendura në paragrafin 1, veprat penale të kryera me qëllim lehtësimin apo kryerjen e këtyre akteve dhe veprat penale që garantojnë mosndëshkimin e këtyre akteve.

3. Në rastin kur mandati i Europol-it ndryshohet për të mbuluar fusha të krimit, përveçse atyre të parashtuara në paragrafin 1, Europol-i mund t'i paraqesë Republikës së Shqipërisë, që prej datës kur hyn në fuqi ndryshimi i mandatit të Europol-it, një propozim me shkrim për të zgjeruar fushën e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me mandatin e ri. Për këtë, Europol-i do të informojë Republikën e Shqipërisë për të gjitha çështjet përkatëse që lidhen me ndryshimin e mandatit. Kjo Marrëveshje do të zbatohet në lidhje me mandatin e ri, që prej datës në të cilën Europol-i merr pranimin me shkrim nga Republika e Shqipërisë, në pajtim me procedurat e brendshme të saj.

4. Për format specifike të kriminalitetit, të përmendura në paragrafin 1 dhe të renditura në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen përkufizimet e përfshira në atë shtojcë. Sa herë që një ndryshim në mandat, siç përmendet në paragrafin 3, sjell detyrimin e pranimin të përkufizimit të një tjetër lloji krimi, ky përkufizim do të zbatohet gjithashtu aty ku kjo formë kriminaliteti bëhet pjesë e kësaj Marrëveshjeje në pajtim me paragrafin 3. Europol-i do të informojë Republikën e Shqipërisë, nëse dhe kur përkufizimi i një fushe të kriminalitetit zgjerohet, ndryshohet apo plotësohet. Përkufizimi i ri do të bëhet pjesë e kësaj Marrëveshjeje që prej datës në të cilën Europol-i merr pranimin me shkrim për përkufizimin nga ana e Republikës së Shqipërisë. Çdo ndryshim në dokumentin në të cilin përmendet përkufizimi do të konsiderohet edhe si ndryshim i përkufizimit.

Neni 4

Pika kombëtare e kontaktit

1. Republika e Shqipërisë cakton njësinë e Europol-it (në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit Shqiptar) që të veprojë si pikë kombëtare kontakti ndërmjet autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Europol-it.

2. Takime të nivelit të lartë ndërmjet autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Europol-it do të zhvillohen të paktën një herë në vit dhe sa herë që të jetë e nevojshme për të diskutuar çështje që lidhen me këtë Marrëveshje dhe me bashkëpunimin në përgjithësi.

3. Pikat e kontaktit të caktuara nga Republika e Shqipërisë dhe Europol-i do të konsultohen me njëra-tjetrën rregullisht për çështje politikash dhe problemesh të interesit të përbashkët, me qëllim realizimin e objektivave të tyre dhe koordinimin e aktiviteteve të tyre përkatëse.

Neni 5

Autoritetet kompetente

1. Autoritetet e zbatimit të ligjit në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë përgjegjëse në kuadrin e ligjit kombëtar, për parandalimin edhe luftën kundër veprave penale të përmendura në nenin 3(1) (më poshtë të referuara si “autoritete kompetente”), janë renditur në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Republika e Shqipërisë do të njoftojë Europol-in për çdo ndryshim në këtë listë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve.

2. Kur është e përshtatshme, do të organizohen konsultime në nivelin e kërkuar ndërmjet përfaqësuesve të autoriteteve të zbatimit të ligjit të Republikës së Shqipërisë dhe Europol-it, autoritete që janë përgjegjëse për fushat e kriminalitetit në të cilat zbatohet kjo Marrëveshje, për të rënë dakord mbi mënyrën më efektive për të organizuar autoritetet e tyre të veçanta.

Neni 6

Shkëmbimi i informacionit

1. Shkëmbimi i informacionit të specifikuar në këtë Marrëveshje do të kryhet vetëm në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

2. Shkëmbimi i informacionit të specifikuar në këtë Marrëveshje do të kryhet ndërmjet pikave të kontaktit të përcaktuara në kuadrin e nenit 4 dhe, kur pikat e kontaktit e konsiderojnë të përshtatshme, mund të përfshijë shkëmbime të drejtpërdrejta të informacionit me autoritetet e zbatimit të ligjit, të identifikuar sipas nenit 5.

3. Informacioni i shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoret vetëm për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe në hetimin, ndjekjen penale dhe parandalimin e veprave penale dhe në procedurat që lidhen me çështjet penale.

4. Europol-i do t'i japë Republikës së Shqipërisë vetëm informacionin që është mbledhur, ruajtur dhe transmetuar në pajtim me dispozitat përkatëse të Konventës (së Europol-it) dhe me rregullat e zbatimit të saj.

5. Pala që jep informacionin mund të përcaktojë kushte për përdorimin e mëtejshëm të tij. Këto kushte mbi përdorimin e informacionit mund të eliminohen vetëm me miratimin me shkrim të Palës që jep informacionin.

6. Informacioni i marrë në pajtim me këtë Marrëveshje nuk do të përdoret për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat ai është dhënë pa miratimin e Palës dhënëse.

7. Informacioni i marrë në pajtim me këtë Marrëveshje, nuk mund të ndahet me palë të treta, përveç Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian, pa pranimin paraprak të Palës që ka dhënë informacionin.

Neni 7

Kërkesa për ndihmë

Bashkëpunimi brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje do të kryhet mbi bazën e kërkesave me shkrim për ndihmë ose me iniciativë të njëres prej Palëve, nëse kjo Palë konsideron se kjo ndihmë është në interes të Palës tjetër.

Neni 8

Zbatimi i kërkesave

1. Pala e kërkuar do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar një zbatim të shpejtë dhe të plotë të kërkesës. Pala kërkuese do të njoftohet menjëherë rreth çdo rrethane që mund të pengojë zbatimin e kërkesës apo të vonojë në mënyrë të konsiderueshme zbatimin e saj.

2. Pala e kërkuar do të ketë të drejtën të kërkojë të dhëna të mëtejshme, të cilat ajo i vlerëson të nevojshme për të zbatuar në mënyrën e duhur kërkesën.

3. Pala kërkuese mund t'i kërkojë Palës së kërkuar të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar konfidencialitet të faktit që u bë kërkesa, të përmbajtjes së kërkesës dhe të çdo dokumenti bashkëlidhur, ashtu edhe të faktit që ajo ka dhënë ndihmë.

4. Pala e kërkuar do të informojë Palën kërkuese nëse ajo nuk ka mundësi të zbatojë kërkesën duke ruajtur konfidencialitetin e saj, Pala kërkuese do të vendosë nëse është e pranueshme të zbatohet kërkesa në bazë të këtyre kushteve.

5. Pala e kërkuar do të informojë Palën kërkuese për rezultatet e zbatimit të kërkesës sa më shpejt që të ketë mundësi.

Neni 9

Shkëmbimi i ekspertizës

Përfaqësuesit e Palëve, kur është e përshtatshme:

- a) do të marrin pjesë në seminare, kurse trajnimi dhe takime të tjera; dhe
- b) do të lehtësojnë vizitat e ekspertëve, autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe administratorëve, në fushat e kriminalitetit që mbulohen nga kjo Marrëveshje.

Neni 10

Konfidencialiteti

1. I gjithë informacioni i përpunuar nga Europol-i apo nëpërmjet Europol-it, me përjashtim të informacionit që dallohet qartë apo që është qartësisht i kuptueshëm si informacion publik, i nënshtrohet një niveli bazë mbrojtjeje brenda organizatës Europol, ashtu edhe në Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian. Informacioni, i cili i nënshtrohet vetëm një niveli bazë mbrojtjeje, nuk kërkon etiketim të veçantë të një niveli klasifikimi të Europol-it, por do të emërtohet si informacion i Europol-it.

2. Palët do të sigurojnë nivelin bazë të mbrojtjes së përmendur në paragrafin 1 për të gjithë informacionin e shkëmbyer në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, nëpërmjet një sërë masash, duke përfshirë detyrimin për maturi dhe konfidencialitet, duke kufizuar të drejtën për përdorimin e këtij informacioni vetëm për personelin e autorizuar dhe një sërë masash të përgjithshme teknike dhe procedurale që mbrojnë sigurinë e informacionit.

3. Informacioni që kërkon masa shtesë sigurie i nënshtrohet një niveli klasifikimi të Republikës së Shqipërisë ose Europol-it, gjë e cila tregohet nga një etiketim/shënim i veçantë. Informacionit i jepet një nivel i tillë klasifikimi vetëm kur është saktësisht e nevojshme dhe vetëm për kohën që është e nevojshme.

4. Nivelet e klasifikimit të Palëve dhe emërtimi i tyre specifikohen në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe i referohen paketave të veçanta të sigurisë, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve. Nivelet e klasifikimit lidhen me paketat e veçanta të sigurisë, të cilat ofrojnë nivele të ndryshme mbrojtjeje në varësi të përmbajtjes së informacionit, dhe marrin parasysh efektin dëmtues që mund të ketë mbi interesin e Palëve aksesit, përhapja ose përdorimi i informacionit në mënyrë të paautorizuar. Palët marrin përsipër që t'i japin mbrojtje të barasvlefshme informacionit të etiketuar/shënuar me një nivel klasifikimi, në përputhje me tabelën e ekuivalencës së niveleve të klasifikimit të përfshirë në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Republika e Shqipërisë do të sigurojë që autorizimet për të drejtën për të njohur dhe përdorur informacion të etiketuar/shënuar për mbrojtje dhe mbrojtja për këtë lloj informacioni do të pranohen nga të gjitha autoritetet kompetente të cilave mund t'u transmetohet informacion në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 11

Procedurat e konfidencialitetit

1. Çdo Palë do të jetë përgjegjëse për zgjedhjen e nivelit të duhur të klasifikimit në përputhje me nenin 10 për informacione që i jepen Palës tjetër.

2. Në zgjedhjen e nivelit të klasifikimit, çdo Palë do të mbështetet në klasifikimin e informacionit sipas ligjit kombëtar apo rregullave të zbatueshme dhe do të marrë parasysh nevojën për

fleksibilitet dhe kërkesën që klasifikimi i informacionit për zbatimin e ligjit duhet të jetë një përjashtim dhe që, nëse një informacion i tillë duhet të klasifikohet, duhet caktuar niveli më i ulët i mundshëm.

3. Nëse secila prej Palëve mbi bazën e informacioneve që tashmë ka në zotërim arrin në përfundimin që zgjedhja e nivelit të klasifikimit duhet të ndryshohet, ajo do të njoftojë Palën tjetër dhe do të tentojë të bjerë dakord mbi një nivel të përshtatshëm klasifikimi. Asnjëra nga Palët nuk do të specifikojë apo ndryshojë një nivel klasifikimi të informacionit të dhënë nga Pala tjetër pa pranimin e asaj Pale.

4. Secila Palë mund të kërkojë në çdo kohë një ndryshim të nivelit të klasifikimit që lidhet me informacionin që ajo ka dhënë, duke përfshirë një heqje të mundshme të këtij niveli. Pala tjetër do të ndryshojë nivelin e klasifikimit në pajtim me këto kërkesa. Secila Palë do të kërkojë ndryshimin e nivelit të klasifikimit në një nivel më të ulët ose heqjen e tij, sa më shpejt që rrethanat ta lejojnë një gjë të tillë.

5. Çdo Palë mund të specifikojë periudhën kohore për të cilën do të zbatohet zgjedhja e nivelit të klasifikimit, si dhe çdo ndryshim të mundshëm në nivelin e klasifikimit pas kësaj periudhe.

6. Kur informacioni, të cilit i ndryshohet niveli i klasifikimit në përputhje me këtë nen, u është dhënë tashmë një ose më shumë Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian ose Palëve të treta, Europol-i, me kërkesë të njësisë së Europol-it (në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit), do të informojë marrësit për ndryshimin në nivelin e klasifikimit.

Neni 12

Oficerët ndërlidhës

Nëse kërkohet për rritje të mëtejshme të bashkëpunimit, ashtu siç është vendosur në këtë Marrëveshje, me qëllimin për të përfunduar në marrëveshje operationale, Republika e Shqipërisë dhe Europol-i mund të bien dakord për emërtimin e një ose më shumë oficerëve ndërlidhës. Funksionet, detyrat dhe statusi i oficerëve ndërlidhës do t'i nënshtrohen konsultimeve, me qëllimin për të përfunduar një marrëveshje ndërlidhjeje.

Neni 13

Shpenzimet

Palët do të përballojnë shpenzimet e veta, të cilat lindin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe rast pas rasti.

Neni 14

Shqyrtimi i dokumenteve

1. Nëse si rezultat i përpunimit të paautorizuar apo të parregullt të informacionit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, një Pale ose një individ i shkaktohet dëm nga Pala tjetër, kjo e fundit do të jetë përgjegjëse për këto dëme.

2. Në raste kur Europol-i është i detyruar t'u paguajë Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian ose një shteti tjetër të tretë ose organizmi të tretë shuma që jepen si kompensim për dëmet ndaj një Pale të cenuar, dhe dëmet kanë ardhur për shkak të mosplotësimit nga Republika e Shqipërisë të detyrimeve në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, Republika e Shqipërisë do të jetë e detyruar të dëmshpërblejë, në bazë kërkesë, shumat të cilat Europol-i i pagoi një Shteti Anëtar ose një shteti tjetër të tretë ose një organizmi të tretë për të shlyer shumat e paguara në kompensim.

3. Në rast se nuk arrihet një marrëveshje mbi përcaktimin dhe kompensimin e dëmeve ndërmjet Palëve në kuadrin e këtij neni, çështja do të vendoset në përputhje me procedurën e vendosur në nenin 15.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet përfaqësuesve të Palëve.

Neni 16
Klauzolë e veçantë

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të cenohet ose përndryshe nuk do të ketë ndikim mbi dispozitat e ndonjë traktati apo marrëveshjeje për ndihmë të ndërsjellë ligjore, marrëdhëniet e punës për zbatimin e ligjit apo mbi çfarëdo marrëveshjeje apo ujudi tjetër për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe çdo Shteti Anëtar të Bashkimit Europian. Megjithatë, dispozitat përsa i përket përpunimit të informacionit të përmendur në këtë Marrëveshje, do të respektohen nga Palët në lidhje me të gjithë informacionin e shkëmbyer në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17
Përfundimi i Marrëveshjes

Kësaj Marrëveshjeje mund t'i jepet fund me shkrim nga secila prej Palëve me anë të njoftimit prej tre muajsh.

Neni 18
Ndryshimet dhe shtesat

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë nëpërmjet miratimit të ndërsjellë ndërmjet Palëve. Të gjitha ndryshimet dhe shtesat duhet të jenë me shkrim. Europol-i mund të japë miratimin e tij për ndryshimet vetëm pas miratimit të këtyre ndryshimeve nga Këshilli i Bashkimit Europian.

2. Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohen nëpërmjet një shkëmbimi note ndërmjet Palëve.

3. Palët do të hyjnë në konsultime në lidhje me ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje ose shtojcave të saj me kërkesën e secilës prej tyre (Palëve).

Neni 19
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Republika e Shqipërisë njofton Europol-in me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike që ajo ka ratifikuar këtë Marrëveshje.

Bërë në Hagë, më pesë shkurt dy mijë e shtatë, në dy kopje, në gjuhët shqipe dhe angleze, duke qenë secila nga tekstet njëllor të barasvlefshme.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
ZV.MINISTRI I BRENDSHËM
Gjergj Lezhja

PËR EUROPOL-IN
DREJTOR
Max-Peter Ratzel

SHTOJCA 1
**PËRKUFIZIMI I FORMAVE TË KRIMIT TË PËRMENDURA NË NENIN 3 TË MARRËVESHJES
STRATEGJIKE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE EUROPOL-IT**

Përsa i përket formave të krimit të përfshira në nenin 3 (1) të kësaj Marrëveshjeje, Europol-i do të përdorë, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, përkufizimet e mëposhtme:

- "trafikim i paligjshëm i drogës" nënkupton veprat penale të renditura në nenin 3 (1) të Konventës së Kombeve të Bashkuara të 20 dhjetorit 1988 kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope dhe në dispozitat që ndryshojnë ose zëvendësojnë atë Konventë;

- "krime të lidhura me lëndët bërthamore dhe radioaktive" nënkuptojnë veprat penale të renditura në nenin 7 (1) të Konventës mbi Mbrojtjen Fizike të Materialit Bërthamor, nënshkruar në Vjenë dhe në Nju-Jork më 3 mars 1980, dhe që lidhet me lëndët bërthamore dhe/ose radioaktive që përkufizohen në nenin 197 të Traktatit të Euroatomit dhe Direktivës 80/836 Euroatom të 15 korrikut 1980;

- "kontrabandë e paligjshme imigrantësh" nënkupton aktivitetet, që synojnë qëllimisht të lehtësojnë, për qëllime fitimi, hyrjen, qëndrimin apo punësimin në territorin e Republikës së Shqipërisë

dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian, kundër rregullave dhe kushteve që zbatohen në territoret e tyre;

- “trafik i qenieve njerëzore” nënkupton nënshtrimin e një personi nga ndikimi real dhe i paligjshëm i personave të tjerë nëpërmjet përdorimit të dhunës ose nëpërmjet shpërdorimit të autoritetit ose nëpërmjet intrigës, veçanërisht me synimin për shfrytëzim prostitucioni, për forma të shfrytëzimit seksual dhe përdhunim të miturish ose tregti me fëmijët e braktisur. Këto forma shfrytëzimi përfshijnë gjithashtu prodhimin, shitjen ose shpërndarjen e materialeve të pornografisë me fëmijë;

- “krim me mjete motorike” nënkupton vjedhje ose përvetësim të paligjshëm të mjeteve motorike, kamionëve, rimorkiove, ngarkesave të kamionëve apo rimorkiove, autobusëve, motoçikletave, furgonëve dhe automjeteve bujqësore; automjeteve në fabrika dhe ofiçina, dhe pjesëve të këmbimit për këto mjete, dhe marrja në dorëzim dhe fshehja e këtyre objekteve;

- “falsifikim i parasë dhe mjeteve të pagesës” nënkupton aktet e përkufizuara në nenin 3 të Konventës së Gjenevës të 20 prillit 1929 mbi Goditjen e Falsifikimit të Monedhës, që zbatohet si për kartmonedhat, ashtu edhe për mjetet e tjera të pagesës;

- “aktivitete të paligjshme të pastrimit të parave” nënkupton veprat penale të renditura në nenin 6, paragrafët 1 dhe 3 të Konventës së Këshillit të Europës, mbi pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, nënshkruar në Strasburg më 8 nëntor 1990.

SHTOJCA 2

E MARRËVESHJES STRATEGJIKE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHËRBIMIT POLICOR EUROPIAN

Autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, përgjegjëse sipas ligjit kombëtar për parandalimin dhe luftimin e veprave penale të përmendura në nenin 3 (1) të Marrëveshjes Strategjike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor Europian janë:

Policia Shqiptare e Shtetit;

Shërbimi Informativ Shtetëror;

Prokuroria;

Drejtoria për Parandalimin e Pastrimit të Parave (në Ministrinë e Financave).

SHTOJCA 3

E MARRËVESHJES STRATEGJIKE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHËRBIMIT POLICOR EUROPIAN

Palët, në përputhje me nenin 10 (4) të Marrëveshjes për Bashkëpunim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor Europian, vendosin që nivelet e mëposhtme të klasifikimit, në kuadrin e legjislacionit kombëtar të Republikës së Shqipërisë dhe nivelet e klasifikimit të përdorura brenda Europol-it, janë të barasvlefshme.

Për Republikën e Shqipërisë

Për Europol-in

“I kufizuar”

Ky nivel zbatohet për informacionin, zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të dëmtojë aktivitetin normal të shtetit dhe interesin ose efikasitetin e institucioneve shtetërore.

“I rezervuar për Europol-in”

Ky nivel zbatohet për informacione dhe materiale, zbulimi i paautorizuar i të cilëve mund të sjellë disavantazhe për interesat e Europol-it ose një apo më shumë vendeve anëtare.

“Konfidencial”

Ky nivel zbatohet për informacionin, zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të dëmtojë sigurinë kombëtare.

“Konfidencial për Europol-in”

Ky nivel zbatohet për informacione dhe materiale, zbulimi i paautorizuar i të cilëve mund të dëmtojë interesat themelore të Europol-it ose një apo më shumë vendeve anëtare.

“Sekret”

Ky nivel zbatohet për informacionin, zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të dëmtojë seriozisht sigurinë kombëtare.

“Sekret për Europol-in”

Ky nivel zbatohet vetëm për informacione dhe materiale, zbulimi i paautorizuar i të cilëve mund të dëmtojë seriozisht interesat themelore të Europol-it ose një apo më shumë vendeve anëtare.

“Tepër sekret”

Ky nivel zbatohet për informacionin, zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të shkaktojë dëme veçanërisht të rënda për sigurinë kombëtare.

“Tepër sekret për Europol-in”

Ky nivel zbatohet vetëm për informacione dhe materiale, zbulimi i paautorizuar i të cilëve mund të shkaktojë në mënyrë të veçantë dëme tepër të rënda për interesat thelbësore të Europol-it ose një apo më shumë vendeve anëtare.

LIGJ

Nr.9700, datë 26.3.2007

PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA NDIKIMET NDËRKUFITARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit, duke parandaluar ndikime të ndjeshme negative, të cilat mund të shkaktohen nga projekte ose veprimtari, që kërkojnë të zhvillohen në territoret ndërkufitare të shteteve fqinje.

Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet kur projekte ose veprimtari, të përcaktuara në aneksin I të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar”, kërkojnë të ushtrohen në territoret e një shteti fqinj dhe parashikohet të kenë ndikime të ndjeshme negative në mjedis ose në shëndet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Për projektet ose veprimtaritë, që kërkojnë të zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që mund të kenë ndikime të ndjeshme negative në mjedisin e vendeve fqinje apo në hapësirat detare ndërkombëtare, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave vepron në përputhje me kërkesat e Konventës së Kombeve të Bashkuara dhe të ligjeve që rregullojnë fushën e mjedisit.

3. Këshilli i Ministrave, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton rregullat dhe procedurat konkrete, të propozuara nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Mjedis ndërkuftar" janë territoret tokësore dhe nëntoka, hapësirat ujore, detare e liqenore përkrah vijës së kufijve shtetërorë të Republikës së Shqipërisë, si dhe hapësirat ajrore mbi to.

2. "Ndikim ndërkuftar në mjedis" është ndikimi i ndjeshëm negativ, që parashikohet të veprojë në mjedisin ndërkuftar të vendit tonë nga projekte ose veprimtari, të përcaktuara në aneksin I të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkuftar", që kërkohet të zbatohen në territorin e një vendi fqinj dhe ka kuptimin e dhënë në pikën 13 të nenit 3 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit".

3. "Palë e prekur" është Republika e Shqipërisë, kur një projekt ose veprimtari, që kërkohet të instalohet në territorin e një shteti fqinj, parashikohet të ketë ndikim ndërkuftar në territorin e saj.

4. "Palë shkaktare" është secila nga shtetet fqinje, kur ndikimet ndërkuftare të një projekti ose veprimtarie, që do të instalohet në territorin e saj, mund të shfaqen në territorin ndërkuftar shqiptar.

5. "Shtet fqinj" janë shtetet që kanë kufij tokësorë apo ujorë me Republikën e Shqipërisë.

6. "Organ përgjegjës" është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e Republikës së Shqipërisë, si dhe struktura përgjegjëse për mjedisin në një shtet fqinj.

7. "Ligji" është ligji nr.8990, datë 23.1.2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

8. "Konventë" është Konventa e Kombeve të Bashkuara "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkuftar" (Konventa e ESPOO-s), ku Republika e Shqipërisë është palë.

9. "Sekretariat" është sekretariati i konventës së përmendur në pikën 8 të këtij neni.

10. "Ministria" është ministria që mbulon problemet e mjedisit.

11. "Ministër" është titullari që drejton ministrinë që mbulon problemet e mjedisit.

KREU II
MASA PËRGATITORE

Neni 4
Marrëveshjet

1. Për të parandaluar ndotjen dhe dëmtimet e mjedisit e të shëndetit nga ndikimet ndërkuftare, ministria merr nismën dhe fton secilin nga organet përgjegjëse të shteteve fqinje, që janë palë në konventë, të nënshkruajnë me të marrëveshje dy ose shumëpalëshe, ku përcaktohen me hollësi angazhimet e secilës palë, për të siguruar zbatimin e plotë të kërkesave të konventës.

2. Marrëveshjet, sipas pikës 1 të këtij neni, përqendrohen kryesisht në:

a) shkëmbimin e vazhdueshëm të të dhënave për projektet dhe veprimtaritë e përcaktuara në aneksin I të konventës;

b) krijimin e hapësirave për kontakte e komunikime zyrtare dhe jozyrtare ndërmjet specialistëve, pikave të kontaktit dhe autoriteteve qendrore e vendore;

c) formimin e grupeve të përbashkëta për shqyrtimin e dokumentacionit dhe zgjidhjen e problemeve, që dalin gjatë procesit të shqyrtimit;

ç) ndërmarrjen e vlerësimeve të përbashkëta të ndikimit në mjedis dhe hartimin e zbatimit e programeve të njësuara të monitorimit;

d) përcaktimin e metodave për identifikimin, shtrirjen dhe vlerësimin e ndikimeve ndërkuftare në mjedis;

dh) përcaktimin dhe respektimin e afateve për të gjitha veprimet, që kryhen gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkuftar;

e) përcaktimin e shpenzimeve dhe mbulimin e tyre;

ë) vënien në dijeni dhe përfshirjen e publikut në të gjitha fazat e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

f) parandalimin e mosmarrëveshjeve, që mund të lindin gjatë procesit dhe përcaktimin e mjeteve

për zgjidhjen e tyre.

Neni 5

Kërkesa për të marrë dijeni

1. Ministria kërkon periodikisht të informohet nga organi përgjegjës i secilit shtet fqinj, nëse atij i janë paraqitur kërkesa për zbatimin e projekteve apo të veprimtarive, të përcaktuara në aneksin I të konventës, të cilat parashikohet të shkaktojnë ndikime ndërkuftare në territore të ndryshme të vendit tonë.

2. Kur ministria vëren se në një shtet fqinj kanë nisur procedurat e shqyrtimit dhe mund të zbatohet një projekt ose një veprimtari që do të ketë ndikim ndërkuftar, për të cilin nuk ka marrë asnjë njoftim nga organi përgjegjës i këtij shteti, i kërkon atij ta vërë në dijeni për këtë çështje, duke zbatuar rigorozisht kërkesat e konventës, ku ai është palë.

Neni 6

Pjesëmarrja

Kur organi përgjegjës i një shteti fqinj njofton se i janë paraqitur kërkesa për zbatimin e një projekti ose veprimtarie, të përcaktuar në aneksin I të konventës dhe se ai do të fillojë procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, si dhe kur ai ka njoftuar fillimisht vetë për këtë çështje, ministri i bën të ditur zyrtarisht se:

a) Republika e Shqipërisë do të marrë pjesë si palë e prekur dhe se ministria është organi i saj përgjegjës për këtë çështje;

b) ministria do të përfshihet në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, që do të zhvillojë organi përgjegjës i palës shkaktare për projektin ose veprimtarinë konkrete.

Neni 7

Kërkesat fillestare

1. Ministri, pasi ka njoftuar përfshirjen në proces, me cilësinë e organit përgjegjës të palës së prekur, i kërkon organit përgjegjës të palës shkaktare nisjen sa më parë të kontakteve e të bisedimeve, për të qartësuar përgjegjësitë, rolet dhe funksionet që do të ushtrojnë, rregullat e procedurat e zhvillimit të procesit dhe masa të tjera që garantojnë mbarëvajtjen e tij.

2. Ministria, në bisedimet e kësaj faze, synon të arrijë mirëkuptim për hapat që do të ndërmarrë, për kërkesat dhe propozimet që do të paraqesë, si përfaqësuese e palës së prekur, për shmangien, zbutjen dhe eliminimin e ndikimeve ndërkuftare në mjedisin shqiptar.

3. Ministri, gjithashtu, i kërkon organit përgjegjës të palës shkaktare që:

a) projekti ose veprimtaria t'i nënshtrohet vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis;

b) për shqyrtimin e tij të zbatohen, me rreptësi dhe në mënyrë të plotë, kërkesat dhe procedurat e konventës;

c) të paraqesë një përmbledhje të shkurtër të praktikave që, në raste të tilla, përdor për shqyrtimin mjedisor dhe të përcaktojë afatin, brenda të cilit do të kryhet shqyrtimi;

ç) të identifikojë organin vendimmarrës dhe organet e tjera, me të cilat do të realizohen bisedimet në faza të ndryshme të procesit;

d) të shprehet, paraprakisht, për natyrën e mundshme të vendimit që do të merret në përfundim të procesit;

dh) të vërë në dijeni propozuesin se projekti ose veprimtaria, që ai kërkon të zbatojë, do të ketë ndikime ndërkuftare, do t'i nënshtrohet shqyrtimit të parashikuar për këtë rast, do të përballojë shpenzimet shtesë të domosdoshme, si dhe do ta njoftojë zyrtarisht për mënyrën e mbulimit të shpenzimeve.

Neni 8

Propozimet

1. Ministria formulon dhe i përcjell organit përgjegjës të palës shkaktare edhe propozimet përkatëse, në funksion të zhvillimit cilësor të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

2. Propozimet përqendrohen kryesisht:

a) në vendosjen bashkërisht nëse projekti ose veprimtaria konkrete përfshihet në aneksin I të konventës;

b) në shqyrtimin e përbashkët të kritereve, sipas së cilave një ndikim konkret në mjedis vlerësohet i zakonshëm apo ndërkuftar;

c) në përcaktimin, gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të rasteve ku duhet bashkëpunuar;

ç) për pjesëmarrjen e specialistëve shqiptarë në procesin e vlerësimit;

d) për krijimin e grupeve të përbashkëta, për të studiuar dhe për të propozuar zgjidhje për çështjet që dalin gjatë procesit të vlerësimit;

dh) për vlerësimin e dokumenteve dhe të raporteve të hartuara nga grupet, duke shprehur edhe qëndrimin e vet për to.

3. Kur organi përgjegjës i palës shkaktare nuk është dakord me ndonjërin nga kërkesat e pikës 2 të këtij neni, ministria kërkon të vihet në dijeni për shqyrtimet e bëra pa praninë e saj dhe për përfundimet e arritura.

Neni 9

Njoftimi

Ministri, në mbledhjen më të afërt, vë në dijeni Këshillin e Ministrave për rastin që është shfaqur, për qëndrimin e tij për t'u angazhuar si palë e prekur, për hapat që do të ndërmerren dhe për rolin që do të luajë në parandalimin e ndikimeve ndërkuftare në shëndet dhe mjedis, duke bashkëpunuar me palën shkaktare, në përputhje me kërkesat e konventës dhe të këtij ligji.

Neni 10

Marrëdhëniet me sekretariatit

1. Ministri, pas komunikimeve paraprake me organin përgjegjës të palës shkaktare, brenda një muaji nga data e komunikimit të fundit, njofton sekretariatit e konventës për rastin e shfaqur dhe i kërkon angazhim për zgjidhjen e çështjes, në përputhje me kërkesat e konventës.

2. Ministri i vë në dispozicion sekretariatit, gjatë të gjithë zhvillimit të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, dokumente e materiale, që ajo i vlerëson si të nevojshme.

Neni 11

Njoftimi i organeve të qeverisjes vendore

Ministri, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit për të marrë pjesë në proces, si palë e prekur, njofton organet e qeverisjes vendore (bashkinë, komunën dhe qarkun), Këshillin e Basenit Ujëmbledhës dhe agjencinë rajonale të mjedisit, ku shtrihet zona që mund të pësojë ndikime ndërkuftare, për rastin e shfaqur, për angazhimet e ministrisë dhe për bashkëpunimin e detyrat për të parandaluar këto ndikime.

Neni 12

Bërja publike

1. Ministri, pas njoftimeve, bën publik rastin, qëndrimin e ministrisë, kontaktet e para me organin përgjegjës të palës shkaktare, si dhe hapat që do të ndërmerren në vijim.

2. Ministria, gjatë zhvillimit të procesit të vlerësimit, boton përmbledhjen e dokumenteve të ardhura nga organi përgjegjës i palës shkaktare dhe të dokumenteve të palës shqiptare drejtuar këtij organi.

3. Ministria harton dhe paraqet komunikata, deklarata, organizon konferenca shtypi dhe emisione televizive, për të vënë në dijeni publikun për ecurinë e procesit.

KREU III SHQYRTIMI

Neni 13

Kërkimi i dokumenteve

1. Ministri, pasi merr përgjegje nga organi përkatës i palës shkaktare për kërkesat dhe propozimet që i ka dërguar, i kërkon atij dokumentacionin teknik të projektit ose të veprimtarisë, raportin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, si dhe përcaktimin e afatit të shqyrtimit të tyre nga ministria.

2. Ministria, për dokumentacionin teknik të projektit ose veprimtarisë, respekton kërkesat e organit përgjegjës të palës shkaktare për konfidencialitetin dhe sekretin teknologjik.

Neni 14

Shqyrtimi i dokumenteve

1. Ministri, për një shqyrtim sa më cilësor të dokumenteve të ardhura, ua përcjell ato ministrive që lidhen drejtpërdrejt me projektin ose veprimtarinë që kërkohet të ushtrohet.

2. Ministrinë, pasi shqyrtojnë dokumentacionin me specialistët e tyre, paraqesin me shkrim, brenda 10 ditëve, qëndrimin zyrtar të tyre në ministri.

Neni 15

Hartimi i raportit

1. Ministri, për shqyrtimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të dërguar nga organi përgjegjës i palës shkaktare, urdhëron ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës së mjedisit, nga ministrinë e linjës dhe organet e specializuara kërkimore-shkencore, që lidhen me natyrën e projektit dhe llojin e veprimtarisë që shqyrtohet.

2. Grupi i punës, brenda afateve të caktuara në urdhrin e ministrit, përgatit raportin, i cili përmban:

a) vlerësimet për nivelin teknik, shkencor e metodologjik të dokumenteve, të dërguara nga organi përgjegjës i palës shkaktare dhe sugjerimet për përmirësimin e tyre, për të garantuar zhvillimin cilësor të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

b) ndikimet ndërkuftare, që dalin nga dokumentet dhe masat për zgjidhjen, për zbutjen apo eliminimin e tyre;

c) përcaktimin dhe përshkrimin e hollësishëm të zonës, mbi të cilën do të ndikojë ndotja ndërkuftare;

ç) masa të tjera, që zvogëlojnë maksimalisht ndikimet ndërkuftare në mjedisin shqiptar gjatë zbatimit të projektit.

3. Raporti i miratuar nga ministri i dërgohet organit përgjegjës të palës shkaktare, duke i kërkuar të japë vlerësimet dhe zgjidhjet e tij.

Neni 16

Dosja e zonës

1. Ministria, në kuadër të përgatitjes së dokumenteve që do t'i dërgohen organit përgjegjës të palës shkaktare, organizon dhe drejton punën për hartimin e raportit të vlerësimit mjedisor të zonës që do të ndikohet dhe krijon dosjen e zonës.

2. Ministria, për të plotësuar dosjen e zonës, kërkon bashkëpunimin e ministrive të linjës, të organeve përkatëse të qeverisjes vendore dhe të organeve të tjera të posaçme për dokumente e të dhëna, për vlerat e zonës dhe ndjeshmërinë mjedisore të saj.

3. Dosja e zonës i përcillet organit përgjegjës të palës shkaktare, duke i kërkuar që të mbahet parasysh gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis e, sidomos, gjatë vendimmarrjes.

4. Nëse organi përgjegjës i palës shkaktare paraqet rezerva për dosjen e zonës, ministria propozon krijimin e një grupi të përbashkët specialistësh, për shqyrtimin në vend të tipareve dhe të veçorive të zonës që do të pësojë ndikime ndërkufitare. Ky grup, në përfundim të punës, paraqet me shkrim mendimet pranë organit përgjegjës të palës shkaktare.

5. Organet e qeverisjes vendore evidentojnë vlerat që përfaqëson zona, popullsinë, urbanizimin, veprimtaritë tradicionale dhe synimet për zhvillimin e saj.

6. Këshilli i Basenit Ujëmbledhës, Komiteti i Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur, kur ka të tilla dhe agjencia rajonale e mjedisit përgatisin të gjithë dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik, që pasqyron statusin dhe treguesit mjedisorë të zonës që do të ndikohet. Këto struktura evidentojnë të dhëna konkrete për përcaktimin e kufijve maksimalë të zonës që mund të preket nga ndikimet ndërkufitare, duke përshkruar ndjeshmërinë mjedisore të saj, duke identifikuar ndikimin maksimal ndërkufitar në zonë, në tërësi e për çdo përbërës të veçantë të saj, si ujërat, tokën, ajrin, pyjet e biodiversitetin.

Neni 17

Shqyrtimi ndërkufitar

1. Vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar, të një projekti apo veprimtarie, ministria e mbështet në:

- a) llojin dhe natyrën e veprimtarisë apo të projektit që do të zbatohet;
- b) madhësinë dhe kapacitetin e projektit;
- c) teknologjitë që do të përdoren;
- ç) sasinë dhe llojin e energjisë që do të shfrytëzohet;
- d) llojet dhe sasinë e mbetjeve që gjenerohen për një cikël prodhimi apo për një afat kohor të dhënë;
- dh) shkarkimet në tokë, ujë dhe ajër;
- e) veçoritë e zonës, që mund të ndikohet nga zbatimi i projektit, si:
 - i) zona ndërkufitare me ndjeshmëri të madhe mjedisore (laguna, parqe kombëtare, rezervate natyrore, habitate me biodiversitet specifik apo zonë me vlera të veçanta të peizazhit);
 - ii) zona ndërkufitare me interes shkencor të veçantë ose me vlera arkeologjike, kulturore dhe historike;
 - iii) zona ndërkufitare me popullsi të dendur, ku projekti i propozuar mund të ketë ndikim negativ shoqëror, ekonomik, kulturor e shëndetësor;
 - iv) zona ndërkufitare me specie të rralla dhe të rrezikuara, ku projekti mund të kërcënojë ekzistencën e tyre ose përdorimin e mundshëm të burimeve të një mjedisi, tej kapacitetit mbajtës së tij;
- ë) përhapja e ndotjes në një shkallë e shtrirje të tillë, që mund të rrezikojë rëndë burimet natyrore dhe shëndetin e popullsisë.

2. Nëse pas shqyrtimit ndërkufitar palët nuk bien dakord me shkallën e ndikimit në mjedisin ndërkufitar, atëherë ministria kërkon ngritjen e një komisioni të përbashkët për verifikimin e dokumentacionit të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili do të përgatisë një raport të përbashkët, që do t'i paraqitet komisionit të shqyrtimit të vendit shkaktar.

Neni 18

Kërkesa për këshillim

1. Ministri, në varësi të projektit apo veprimtarisë, të nivelit të dokumentacionit të paraqitur e të problemeve që kanë dalë, kërkon nga organi përgjegjës i palës shkaktare këshillime të përbashkëta në nivel ekspertësh ose organesh.

2. Në kërkesën për këshillim saktësohet objekti, dokumentet e materialet që do të studiohen, ekspertët që propozohen të marrin pjesë, koha në dispozicion, materiali që pritët nga këshillimi dhe mënyra e shqyrtimit të tij nga organet përkatëse.

Neni 19

Grupi i këshilluesve

1. Ministri, pas përgjigjes pozitive të organit përgjegjës për këshillime, cakton grupin e

këshilluesve, të cilin e përzgjedh nga grupi që ka shqyrtuar dokumentet e ka hartuar raportin, sipas kërkesave të nenit 15 të këtij ligji.

2. Grupi duhet të ketë parasysh që këshillimet të përqendrohen në:

a) përcaktimin e variantit më të mirë të mundshëm për projektin e propozuar, duke iu referuar teknologjisë, mundësisë, vendit të instalimit, llojit dhe nivelit të ndikimeve ndërkufitare që do të shkaktojë, treguesve mjedisorë dhe vlerave të zonës që do të ndikohet;

b) forcimin e masave të propozuara për zbutjen e ndikimit ndërkufitar;

c) përcaktimin e formave të tjera të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë, për zvogëlimin dhe eliminimin e ndikimeve ndërkufitare;

ç) paraqitjen e rezultateve në raportin përfundimtar të grupit, i cili i dorëzohet organit përgjegjës të palës shkaktare dhe ministrisë.

3. Ministria, sipas rastit, miraton apo formulon rezervat e pretendimet e saj për raportin dhe ia përcjell organit përgjegjës të palës shkaktare, duke i sugjeruar edhe zgjidhjet.

Neni 20

Grupet dhe komisionet

Grupet dhe komisionet, qofshin të një pale ose të përbashkëta, janë organizma ndihmës, të ngritur posaçërisht për të studiuar një apo disa çështje gjatë procesit dhe për t'u sugjeruar zgjidhje e alternativa organeve që i kanë krijuar, të cilat kanë të drejtën të vendosin.

KREU IV

PJESËMARRJA E PUBLIKUT

Neni 21

Pjesëmarrja e publikut

1. Ministria kërkon nga organi përgjegjës i palës shkaktare të sigurojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të publikut dhe të organeve të qeverisjes vendore të zonës që mund të preket nga ndikimet ndërkufitare.

2. Ministria, gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të një veprimtarie ose projekti, të përcaktuar në aneksin I të konventës, i kërkon organit përgjegjës të palës shkaktare të njëjtin angazhim, si dhe zbatimin e kërkesave e të procedurave të njëjta, për të siguruar edhe pjesëmarrjen e publikut shqiptar në këtë proces.

Neni 22

Përmbajtja

Pjesëmarrja e publikut në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar, nënkupton:

a) përcaktimin e përbërjes së publikut, për rastin konkret, si përfaqësues të banorëve të zonës, të qeverisjes vendore, të organizatave jofitimprurëse mjedisore, të biznesit, të shtypit e të mediave, qendrore e vendore;

b) njoftimin e tij për projektin, për ndikimet ndërkufitare që do të sjellë, si dhe për masat që do të zbusin këto ndikime;

c) sigurimin e kushteve të përshtatshme, në mënyrë që publiku të japë mendimet në diskutimet për projektin gjatë të gjitha fazave të këtij procesi;

ç) sigurinë procedurale se mendimet e publikut do të shqyrtohen veçanërisht gjatë vendimmarrjes dhe qëndrimi ndaj tyre do të pasqyrohet në tekstin e vendimit.

Neni 23

Lehtësimi i procedurave

Ministria, për të siguruar pjesëmarrje dhe rol aktiv të publikut të zonës që do të preket, i komunikon organit përgjegjës të palës shkaktare se merr përsipër:

a) organizimin dhe realizimin e pjesëmarrjes së publikut, të organeve të qeverisjes vendore, të organizatave jofitimprurëse, të shtypit dhe të mediave vendore;

- b) përkthimin në gjuhën shqipe të dokumenteve të dërguara për publikun nga organi përgjegjës i palës shkaktare dhe shpërndarjen e tyre;
- c) organizimin e takimeve e të këshillimeve me propozuesin dhe ekspertë të tij, nëse kjo do të kërkohet;
- ç) realizimin e debatit publik, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.8990, datë 23.1.2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";
- d) grumbullimin dhe sistemimin e kërkesave, të vërejtjeve dhe propozimeve të publikut, përkthimin e tyre në anglisht dhe dërgimin në kohë tek organi përgjegjës i palës shkaktare.

Neni 24
Mbulimi i shpenzimeve

Ministria përlogarit të gjitha kostot e shërbimeve që do të kryejë për të realizuar pjesëmarrjen e publikut dhe vë në dijeni për to organin përgjegjës të palës shkaktare, duke i kërkuar mbulimin e tyre, para se të nisë zbatimin në praktikë.

KREU V
VENDIMI

Neni 25
Njohja me vendimin

Ministria organizon studimin e vendimit të organit përgjegjës të palës shkaktare, në bashkëpunim me ministritë e linjës, me organet përkatëse të qeverisjes vendore, me organet e specializuara kërkimore-shkencore dhe me përfaqësues të publikut të angazhuar në proces.

Neni 26
Kërkesat

Ministria, në bazë të studimit të vendimit, formulon kërkesat që do t'i paraqiten organit përgjegjës të palës shkaktare për:

- a) marrjen parasysh të kërkesave të ministrisë e të publikut, të shprehura gjatë procesit;
- b) respektimin e marrëveshjeve të arritura nga palët gjatë kontakteve dhe bisedimeve;
- c) përcaktimin e saktë dhe të plotë të kushteve e të rrethanave, në bazë të të cilave duhet të instalohet dhe të funksionojë projekti ose veprimtaria, që të mos shkaktojë ndikime ndërkuftare.

Neni 27
Propozimet

1. Ministria, në varësi të vendimit të dhënë nga organi përgjegjës i palës shkaktare, harton menjëherë kërkesat e pretendimet, që kanë dalë gjatë studimit të tij, si dhe bën propozime konkrete për plotësimin e tyre dhe ia përcjell ato organit përgjegjës të palës shkaktare, duke i kërkuar thellimin e bashkëpunimit dhe mirëkuptimin e domosdoshëm në këtë proces.

2. Propozimet, përgjithësisht, kanë të bëjnë me rivlerësimin dhe rishqyrtimin e përbashkët:

- a) të llojeve dhe të masës së ndikimeve që do të shfaqen në mjedisin shqiptar;
- b) të përcaktimit të secilit ndikim, nëse ai është ndërkuftar apo një ndikim çfarëdo;
- c) të kushteve e rrethanave të përcaktuara në vendim, për të shmangur ndikimin ndërkuftar të veprimtarisë ose projektit të miratuar.

3. Ministria, në varësi të kërkesave që ka formuluar e të propozimeve të bëra për vendimin, mund të kërkojë vazhdimin e bisedimeve e të bashkëpunimit në një fazë të përcaktuar, pas marrjes së vendimit.

Neni 28
Monitorimi

- 1. Në bisedimet e parashikuara në pikën 3 të nenit 27 të këtij ligji, ministria propozon që:
 - a) veprimtaria të kalojë vetëm në një fazë prove, gjatë së cilës të monitorohen ndikimet e saj

konkrete në mjedisin shqiptar;

b) gjatë fazës së zbatimit dhe të vënies në punë të projektit, të zhvillohet monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë, për të vënë në dukje efektet negative të mundshme të ndikimeve të saj në mjedisin shqiptar.

2. Ministria kërkon që monitorimet, sipas pikës 1 të këtij neni, të realizohen me shpenzimet e propozuesit.

Neni 29

Rezultatet e monitorimit

Kur rezultatet e monitorimit tregojnë se ndikimi në mjedisin ndërkufitar është i ndjeshëm, ministri i kërkon organit përgjegjës të palës shkaktare rishikimin e vendimit të marrë, që ai të pasqyrojë realisht gjendjen dhe të garantojë se nuk do të ketë ndikime ndërkufitare.

Neni 30

Rrethana të reja

Nëse dalin fakte e rrethana të tjera, të paparashikuara më parë, që diktojnë ndryshime tërësore apo të pjesshme të vendimit, ministria vë në dijeni organin përgjegjës të palës shkaktare për këto rrethana, duke dhënë edhe arsyetimet përkatëse dhe i kërkon rivlerësimin e gjendjes dhe ndryshimin e vendimit.

Neni 31

Njoftimi i publikut

Pas përgatitjes së kërkesave e propozimeve për vendimin, ministria e publikon atë, së bashku me pretendimet dhe kërkesat e saj, të cilat ia ka paraqitur organit përgjegjës të palës shkaktare.

Neni 32

Ankimi ndaj vendimit

Kur organi përgjegjës i palës shkaktare nuk i merr parasysh kërkesat e ministrisë për rivlerësimin e gjendjes dhe për ndryshimin e vendimit, me qëllim shmangien e ndikimeve të ndjeshme negative në mjedisin shqiptar, ministri:

a) i paraqet edhe një herë atij pretendimet që ka ngritur vazhdimisht gjatë procesit të shqyrtimit, sidomos ndaj vendimit dhe i njofton se do të përdorë të gjitha mjetet ligjore për të mbrojtur mjedisin shqiptar;

b) njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme për ta ndjekur këtë çështje në rrugë diplomatike me palën shkaktare;

c) njofton sekretariatit e konventës, duke e vënë në dijeni me hollësi për të gjithë gjendjen dhe kërkon angazhimin e tij për të ndikuar te pala shkaktare;

ç) i kërkon Avokatit të Shtetit që, nëse është e mundur, të ndjekë procedurat që çështja të shqyrtohet në një gjykatë ndërkombëtare.

KREU VI

NDIKIME KONKRETE

Neni 33

Konstatimi i dëmtimeve të mjedisit

Kur Inspektorati i Mjedisit, agjencitë rajonale të mjedisit, organet e specializuara kërkimore-shkencore që monitorojnë mjedisin, organet e qeverisjes vendore, organizatat jofitimprurëse mjedisore, përfaqësues të publikut apo shtetas të veçantë të zonave ndërkufitare vërejnë ndotje ose dëmtime të mjedisit, të shkaktuara nga veprimtari që ushtrohen në territorin e një shteti fqinj, njoftojnë ministrinë, e cila, pasi verifikon vërtetësinë e informacionit, komunikon me organin përgjegjës të shtetit fqinj, duke i kërkuar:

- a) fillimin e menjëhershëm të bisedimeve, për të shqyrtuar rastin konkret;
- b) marrjen e masave për ndërprerjen e menjëhershme të ndikimeve ndërkufitare në territorin shqiptar;
- c) angazhimin për rehabilitimin e mjediseve të dëmtuara dhe për shlyerjen e dëmeve materiale.

Neni 34

Aksidentet industriale

1. Kur vërtetohet se ndikimet e ndjeshme negative në mjedis janë pasojë e një aksidenti industrial, që ka ndodhur në një projekt ose veprimtari që zhvillohet në njërin nga shtetet fqinje, ministria vepron menjëherë, sipas kërkesave të konventës "Për aksidentet industriale", ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Kur nga kontrollet, matjet, vëzhgimet e monitorimet vërtetohet se ndikimet e aksidentit industrial janë me pasoja të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin dhe kur ndikimet negative janë shtrirë në një pjesë të gjerë të territorit të Republikës së Shqipërisë, gjendja brenda vendit trajtohet e përballohet sipas kërkesave të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile".

Neni 35

Ndikime të largëta

Kur vërtetohet se ndikimet e ndjeshme negative në mjedis janë pasojë e veprimtarive ose projekteve që zhvillohen në territorin e një shteti jofqinj, ministria:

- a) organizon dhe drejton kontrollet dhe monitorimin e menjëhershëm të cilësive të mjedisit e të shkarkimeve, që vërtetohen në përbërësit e tij, si në ujë, ajër, tokë e biodiversitet;
- b) përcakton llojin, sasinë, intensitetin e ndikimeve negative dhe shtrirjet hapësinore e territoriale të tyre;
- c) njofton shtetasit për zonat e prekura, për ndikimet që janë shfaqur, si dhe i udhëzon për masat që duhet të marrin, për t'u mbrojtur prej tyre;
- ç) njofton shtetin përkatës për llojet e ndikimeve dhe shtrirjen e tyre në territorin e vendit tonë, si dhe kërkon fillimin e menjëhershëm të bisedimeve ndërmjet organeve përkatëse, për të përballuar gjendjen;
- d) i kërkon shtetit përkatës marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e ndikimeve negative;
- dh) i kërkon mbulimin e shpenzimeve për përcaktimin e mjediseve të dëmtuara nga ndikimet negative dhe për rehabilitimin e tyre;
- e) i parashton kërkesat e argumentuara për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga ndikimet negative.

Neni 36

Parapërgatitja

1. Ministria përgatit, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, planet dhe programet e veprimit, kur vërtetohen rrethanat, sipas neneve 34 e 35 të këtij ligji.

2. Planet dhe programet miratohen nga ministri dhe, në bazë të tyre, veprohet për çdo rast konkret.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 37

Formatimi i dokumentacionit

1. Dokumentacioni, që përdoret për komunikimet me organin përgjegjës të palës shkaktare, si kërkesa, propozime, njoftime, informacione e komunikime, standardizohet.

2. Ministria përgatit dhe formaton, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dokumentacionin që do të përdoret në komunikimet me palën shkaktare, i cili miratohet nga ministri.

Neni 38
Gjuha

Për të lehtësuar bashkëbisedimin dhe komunikimin shkresor me organin përgjegjës të palës shkaktare, si dhe për të shmangur mosmarrëveshjet e keqkuptimet, që vijnë për shkak të gjuhës e të përkthimeve, propozohet përdorimi i gjuhës angleze.

Neni 39
Afatet

Angazhimi për përcaktimin e afateve dhe respektimi i tyre gjatë të gjithë procesit janë përgjegjësi parësore të ministrisë, për të mos pasur keqkuptime e mosmarrëveshje në zhvillimin e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkuftar.

Neni 40
Shpenzimet

1. Ministria merr masa për përlogaritjen e të gjitha shpenzimeve të nevojshme dhe shtesë, që do të duhen për të mbuluar kostot:

a) e përgatitjes e të përkthimit të dokumenteve dhe të komunikimeve me organin përgjegjës të palës shkaktare;

b) e veprimtarisë së komisioneve dhe të grupeve të përbashkëta të ekspertëve, si dhe të komisioneve e të grupeve të punës që angazhon ministri gjatë të gjithë procesit;

c) e njoftimit dhe të përfshirjes së publikut në të gjitha fazat e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

ç) e monitorimit të ndikimeve negative të veprimtarisë;

d) e masave shtesë që duhet të marrë propozuesi, për të zbutur dhe eliminuar ndikimet ndërkuftare, për të cilat është rënë dakord ndërmjet palëve;

dh) e shqyrtimit dhe e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që mund të lindin me organin përgjegjës të palës shkaktare.

2. Ministria, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përgatit listën tip të shpenzimeve të mundshme dhe përcakton kriteret, për të përlogaritur vlerën e secilit shpenzim, të cilat miratohen me udhëzim të veçantë të ministrit.

3. Ministria i njofton organit përgjegjës të palës shkaktare kërkesat për shpenzimet, sipas pikës 1 të këtij neni dhe bën të gjitha përpjekjet për të siguruar se të gjitha shpenzimet do të mbulojnë nga ky organ, i cili i siguron ato nga propozuesi i projektit apo nga burime të tjera, sipas legjislacionit e praktikave të vendit të tij.

Neni 41
Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të pikës 2 të nenit 2 të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që, në zbatim të neneve 36 pika 1, 37 pika 2 e 40 pika 2, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 42
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5258, datë 10.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5253, datë 10.4.2007

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika “dh” të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Shpëtim Çausi lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Strasburg.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5254, datë 10.4.2007

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika “dh”, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Margarita Gega emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Strasburg.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5255, datë 10.4.2007

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika “dh”, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ruhi Hado emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Suedisë, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Finlandës, në Republikën e Islandës dhe në Mbretërinë e Norvegjisë, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET

Nr.5256, datë 10.4.2007

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika “dh”, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Tonin Gjuraç emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Shtetin e Izraelit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 - 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500**
 - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

Botime të reja

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 12.4.2007
 Doli nga shtypi më 14.4.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Grafon”
 Tiranë, 2007

Çmimi 24 lekë